33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezuluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-4748-5-1-1/C761

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nenl. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 7 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë për 120 ditë, brenda 12 muajve, sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim nga ZKA. Ky projekt është bashkëfinancim në mes të Komunës së Gjakovës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe DEMOS-it. MAPL-ja dhe DEMOS-i, do të bëjnë monitorimin e kontratës nga fillimi deri në përfundim të saj.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 37 muaj
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Projekti kryesor i rrugës "Martirët e Kombit" nga "Ura e Tabakut" deri te "Ura e Tahir Efendisë", Gjakovë

Paramasa dhe Paralogaria

AKSI 1: L=1+232.11 km, B=7.00 m, bt=2x3.00 m

POS	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi TVSH	Gjithsej totali me TVSH
I	Punët Përgaditore				
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtës. (Zyrja duhet të ketë kushte të mira për punë, e pajsur me inventar, printer, internet, të ketë tavolinë shtesë - të veçant për projekt menaxherin dhe organin mbikëqyrës)	komplet	1.00	1000.00	1,000.00 €
2	Pastrimi i terrenit, kontrollimi i instalimeve nentokesore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasenë e rrugës (vazo, shporta mbeturinash, reklama etj). Materialet e larguara transportohen në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km. Para fillimit të punimeve, Investitori duhet të sigurojë të dhënat e instalimeve. Në rast të dëmtimit të instalimeve ekzistuese, duhet të rregullojë vetë punëkryesi.	m'	1,232.11	0.35	431.24 €
3	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	1,232.11	1.00	1,232.11 €
4	Gërryerja e asfaltit dhe deponimi në vendin e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km. Rruga ka dy shtresa asfalt dhe atë me trashësi 8+4 cm. Materiali i demoluar transportohet në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m2	8,624.00	0.50	4,312.00 €
5	Demolimi i pahive elastike ekzistuese në stacionazhat P49-P51 dhe largimi i tyre në deponi të caktuar nga Investitori	m'	25.00	3.00	75.00 €

6	Demolimi (largimi) i pemëve dhe drunjëve përgjatë rrugës dhe në afërsi të brezit të rrugës. Disa nga pemët mund të përdoren përsëri. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	copë	10.00	20.00	200.00
7	Largimi i shtyllave të ndriçimit me të gjitha elementet e saj (ankeri, themeli, kabllo) dhe transporti në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	copë	9.00	50.00	450.00 €
8	Thyerja e bazave të reklamave dhe bartja e materialit në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	copë	10.00	20.00	200.00 €
9	Demolimi i pllakave nga guri që gjenden skaj asfaltit ekzistues. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km	m2	30.00	6.00	180.00 €
10	Demolimi i kubëzave që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km	m2	1,426.23	6.00	8,557.38 €
11	Demolimi i sipërfaqeve nga beton që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km	m2	622.21	7.00	4,355.47 €
12	Demolimi i rigollës së bashku me beton. Transporti në deponinë e caktuar bëhet nga Investitori. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	m'	48.00	3.00	144.00 €
13	Demolimi i gurëve skajorë 18/24 cm së bashku me beton. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	100.00	2.00	200.00 €
14	Demolimi i gurëve skajorë 10/24 cm së bashku me beton. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	150.50	2.00	301.00 €

15	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese drejtkëndeshe dhe te tjera të elektrikes të cilat kanë nevojë të pershtaten me niveleten e re, duke përfshirë rregullimin e konusit. Rregullimi i kokës së pusetave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet ne deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	2.00	50.00	100.00 €
16	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese drejtkëndeshe dhe tjera të elektrikes te cilat kanë nevojë të pershtaten me niveleten e re, duke përfshirë rregullimin e konusit dhe zenvendësimin e kapakëve te dëmtuar me peshë deri në 42 t. Rregullimi i kokës së pusetave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet ne deponin e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	2.00		0.00 €
17	Demolimi i pusetave ekzistuese te ujesjellësit, kanalizimit fekal apo atmosferik te cilat gjenden në trasen e rrugës së projektuar dhe rregullimi i kokës së pusetave (nga beton-armca) në nivelin e rrugës së re. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	copë	16.00	50.00	800.00 €
18	Demolimi i pusetave ekzistuese te ujesjellësit, kanalizimit fekal apo atmosferik te cilat gjenden në trasen e rrugës së projektuar, dhe rregullimi i pusetave të reja jashtë trupit te rrugës. Në këtë pozicion të përfshihet edhe furnizimi dhe vendosja e kapakëve metalik deri në 42 ton. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga Investitori në largësi max 15 km.	copë	5.00	120.00	600.00 €
15	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese drejtkëndeshe dhe te tjera të PTK të cilat kanë nevojë të pershtaten me niveleten e re, duke përfshirë rregullimin e konusit. Rregullimi i kokës së pusetave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet ne deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	2.00	50.00	100.00 €

16	Demolimi dhe ngritja e pusetave ekzistuese drejtëndeshe dhe tjera të PTK të cilat kanë nevojë të pershtaten me niveleten e re, duke përfshirë rregullimin e konusit dhe zenvendësimin e kapakëve të dëmtuar me peshë deri në 42 t. Rregullimi i kokës së pusetave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	2.00	150.00	300.00 €
19	Demolimi i ujëmbledhësave me të gjitha elementet e tyre përcjellëse siç janë grilla, puseta nga betoni, pllaka e poshtme dhe gypat shkarkues, që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demoluar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	3.00	40.00	120.00 €
21	Dislokimi i shtyllave ekzistuese të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishëm i kabllave ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar.	copë	11.00	200.00	2,200.00 €
22	Dislokimi i shtyllave ekzistuese të drurit si dhe vendosja e shtyllave të reja të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishëm i kabllave ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar.	copë	18.00	250.00	4,500.00 €
23	Demolimi dhe rivendosja e rrethojës (rrethojë, tel me gjemba)	m'	440.00	0.80	352.00 €

24	Demolimi i mureve nga materialet e ndryshme si gurët, betoni apo blloqet, me lartësi mesatare (1.5-2.5) m. Materiali i demoluar transportohet ne deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	157.24	20.00	3,144.80 €
25	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar).	m'	1,232.11	1.00	1,232.11 €
		Gjithsej totali me tvsh			35,087.11 €
II	Punët e Gërmimit				
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e rrugës dhe sanimi i trupit ekzistues ne vendet ku është e nevojshme, bartja e tij ne deponi të përshtatshme në largësi deri ne 15 km e caktuar nga Investitori. Pjesa e materialit të gërmuar e cila është me permbajtje gurore mund te perdoret për mbushje ne profilet ku mbushja është më e madhe se t=1.0 m. Në këtë pozicion është llogaritur edhe rregullimi i kyqeve.	m³	14,575.90	2.00	29,151.80 €
2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >35 MPa.	m²	17,050.40	0.30	5,115.12 €
		Gjithsej totali me tvsh			34,266.92 €
III	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethanor mbushes. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >40 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqeve anësore dhe sanimet në trupin e rrugës nëse ka nevojë	m³	450.00	7.00	3,150.00 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushes 0-150mm t=40 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqeve anësore.	m³	8,588.45	7.00	60,119.15 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63mm, t=20 cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>70 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqeve anësore.	m³	3,538.90	7.00	24,772.30 €

4	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë $M_v > 90$ Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ³	1,691.55	9.00	15,223.95 €
5	Furnizimi, shtrirja e gjeotekstitit 400 gr/m ² Naue ose te ngjajshme (me norma evropiane CE, ETA, EPD, EN ISO 9864, 9863-1, 10319, 12236, 12956, 11058) ne nënbazen e rrugës. Palimi i gjeotekstitit duhet te jete i rregullt 30 cm njeri mbi tjetren. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e gjeotekstitit për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ²	12,075.44	0.70	8,452.81
6	Furnizimi dhe shtrirja e rërës për mbrojtje të gjeotekstitit nga dëmtimet e mundshme t=5.0 cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e rërës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m ³	603.75	10.00	6,037.50 €
7	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave	m ³	315.88	7.00	2,211.16 €
		Gjithsej totali me tvsh			119,966.87 €
IV	Punët e Betonit				
1	Gurët skajorë dhe kubëzat				
1	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e rërës 10-20mm, d=5cm (në gjendje të ngjeshur)	m ³	372.50	10.00	3,725.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i Gurëve skajorë nga betoni 18/24 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm (±2mm)))	m'	2,715.00	10.00	27,150.00 €
3	Furnizimi dhe montimi i Gurëve Skajor nga betoni 10/20 cm, te klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm (±2mm)	m'	2,600.00	6.50	16,900.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i kubëzave nga betoni me trashësi t=6cm për trotuare. Kubëzat duhet të jenë të klasës C-30/37.Ngjyra dhe modeli të zgjedhen	m ²	7,450.00	9.00	67,050.00 €

	nga Investitori.				
		Gjithsej totali me tvsh			114,825.00 €
V	Punët e Asfaltit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit BA 0/22 mm në rrugë, t=8cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e asfaltit për kryqëzimin te sta. P15-P19 dhe sta. P2-P3	m ²	9,746.00	9.00	87,714.00
2	Spërkatja (lyrja) e shtresës së parë të asfaltit me emulzion 0.5 lit/m ² . Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e emulzionit për kryqëzimin e sta. P15-P19 dhe sta. P2-P3	m ²	9,746.00	0.50	4,873.00
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB11-s mm (zhavori është nga guri eruptiv) në rrugë dhe në kycjet e rrugëve ekzistuese, t=4cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e asfaltit për kryqëzimin e sta. P15-P19 dhe sta. P2-P3	m ²	9,746.00	5.00	48,730.00
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 16 mm për kycjet e rrugëve ekzistuese, t=8cm	m ²	418.70	12.00	5,024.40
		Gjithsej totali me tvsh			146,341.40 €
VI	Punët e tjera				
1	Furnizimi dhe mbjellja e fidaneve të drunjëve dekorativ. Në këtë pozicion përfshihet hapja e gropës, mjellja e fidaneve, mbulimi me dhe dhe plehërimi . Lloji i drurit përcaktohet nga Investitori. Lartësia minimale e fidanit duhet të jetë min 2 m. Distanca në mes drunjve duhet të jetë çdo 8 m duke e harmonizuar me hyrjet e bizneseve dhe shtepijave	copë	300.00	35.00	10,500.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e ulëseve përkaj rrugës me (Dim 140cm). Ulëset duhet të jenë me konstruksion të njëjtë me pjesën e realizuar nga druri i ipregnuar rezistent ndaj kushteve atmosferike.	copë	86.00	180.00	15,480.00 €
3	Furnizimi dhe vendosja e shportave për mbeturina. Shportat duhet të jenë metalike jo të korrodeshme, dizajni të pershtatet me shportat ekzistuese të qytetit.	copë	86.00	90.00	7,740.00 €

4	Furnizimi dhe vendosja e grillës metalike (1.20x1.20)m rreth bazës së pemëve, për mbrojtjen e rrënjës dhe mundësinë e rrjedhjes së ajrit dhe ujit. -Grila duhet të siguroj një sipërfaqe të përshtatshme për kembesorët. -Modeli të zgjidhet nga investitori	copë	300.00	120.00	36,000.00 €
11	Furnizimi, rrafshimi dhe përpunimi i dheut për ishujt gjelberues të kryqëzimit të stacionazhat P15-P19. Në çmim përfshihet edhe humusimi t=20 cm i shtresës së sipërme dhe mbjellja e barit 100gr/m².	m2	141.00	6.00	846.00 €
		Gjithsej totali me tvsh			70,566.00 €
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmërisë	komplet	1.00	250.00	250.00 €
2	Testimet e Asfaltit	komplet	1.00	250.00	250.00 €
3	Testimet e gurëve skajorë	komplet	1.00	250.00	250.00 €
4	Testimet e kubëzave të betonit	komplet	1.00	250.00	250.00 €
		Gjithsej totali me tvsh			1,000.00 €

Rekapitulimi		
I	Punët Pregaditore	35,087.11 €
II	Punët e Dheut	34,266.92 €
III	Punët e Zhavorit	119,966.87 €
IV	Punët e Betonit	114,825.00 €
V	Punët e Asfaltit	146,341.40 €
VI	Punët e tjera	70,566.00 €
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	1,000.00 €
GJITHËSEJ TOTALI ME TVSH:		522,053.30 €

Projekti kryesor i rrugës "Martirët e Kombit" nga "Ura e Tabakut" deri te "Ura e Tahir Efendisë", Gjakovë
Kanalizimi atmosferik

Paramasa dhe Parallogaria					
Kolektori I: L1=0+723.94 km					
Kolektori II: L2=0+497.32 km					
Segmenti S53: L=0+025.00 km					
Ltot=1+246.69 km					
POS	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Gjithsej totali me TVSH
I	Punët pregaditore				
1	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në teren duhet të bëhet piketimi i të gjitha pusetave sipas projektit dhe përcjellja e punimeve gjatë ekzekutimit. Në llogari është marrë gjatësia e trasesë nëpër të cilën kalojnë gypat.	m'	1,246.69	1.00	1,246.69 €
2	Kontrolli i instalimeve nëntokësore. Para dhe gjatë gërmimit duhet të identifikohen dhe ruhen të gjitha instalimet ekzistuese, demtimet eventuale të instalimeve nëntokësore do të riparohen nga operatori ekonomik me shpenzime të tij. Para fillimit të punimeve duhet të sigurohen informata nga investitori. Llogaria është dhënë për tërë gjatësinë e trasesë	m'	1,246.69	0.50	623.35 €
3	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast se projekti ndryshon gjatë realizimit).	m'	1,246.69	1.00	1,246.69 €
		Gjithsej totali me tvsh			3,116.73 €
II	Punët tokësore				
I	Gërmimi i kanalit për kolektorit kryesor, kat. III-IV me gjërësi sipas profileve të projektit, dhe transporti i dheut të gërmuar në vendin ku e cakton Investitori, në largësi deri në 5 km. Te largimi i dheut të gërmuar behet vetëm pjesa e mbetur që nuk kthehet në kanal. Po ashtu në këtë pozicion është paraparë edhe gërmimi i materialit për zgjerime tek pusetat. Llogaritja është bërë për nivelin prej fundit të kanalit deri te shtresa e zhavorrit 0-150 mm.				
I.1	Gërmimi me makinë 90%	m³	1,223.00	3.00	3,669.00 €
I.2	Gërmimi me dorë 10 %	m³	122.30	5.00	611.50 €

2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ± 1 cm.	m ²	1,120.22	0.40	448.09 €
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub dhe ngjeshja (10 cm rerë vendosën nën gyp dhe 15 cm mbi gyp dhe pjesa tjetër anash gypit). Në llogari është përfshirë edhe sasia e rerës rreth gypave të ujëmbledhësve.	m ³	602.10	12.00	7,225.20 €
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethanor mbushës për mbulimin e gypave dhe rrethë pusetave. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Llogaria është bërë prej shtresës së rerës deri te niveli i zhavorrit 0-150 mm.	m ³	948.33	5.00	4,741.65 €
5	Furnizimi me material dhe sigurimi i kanalit ndaj shembjes së dheut	m ²	3,908.03	3.00	11,724.09 €
6	Kthimi i dheut të gërmuar (i cili është i pershtashëm për mbushje) në kanal deri në nivelin e terrenit apo të shtresave të rrugës, duke bërë ngjeshjen e tij në shtresa t=25-30cm.	m ³	50.00	2.00	100.00 €
7	Furnizimi dhe vendosja e shiritit paralajmërues për kanalizim, që vendosët 40 cm mbi gyp	m'	1,246.69	0.50	623.35 €
8	Furnizimi, transporti, shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm nën pllakën e poshtme të pusetave, me trashësi t=20 cm. Moduli i ngjeshjes duhet të jetë Mv >50 MPa	m ³	27.64	8.00	221.12 €
		Gjithsej totali me tvsh			29,363.99 €
III	Punët montuese				
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8				
1.1	SN8 Ø 250 mm	m'	400.00	35.00	14,000.00 €
1.2	SN8 Ø 315 mm	m'	416.00	42.00	17,472.00 €
1.3	SN8 Ø 400 mm	m'	431.86	50.00	21,593.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8 Ø 160 mm për ujëmbledhës të kanalizimit atmosferik	m'	300.80	15.00	4,512.00 €

3	SN8 Ø 200 mm për lidhjet e reja që do të bëhen në të ardhmen nga pusetat ndihmëse në rrjetin e kanalizimit atmosferik të projektuar . Gjatësia mesatare e gypave për kyçje është 15 m	m'	180.00	32.00	5,760.00 €
4	Sigurimi dhe montimi i shkallëve prej shufrave të çelikut Ø 25 mm çdo 30 cm sipas detalit në projekt.	copë	320.40	100.00	32,040.00 €
		Gjithsej totali me tvsh			95,377.00 €
IV	Punët e betonit dhe armaturës				
1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C20/25 për pllakën e poshtme për puseta, d=20 cm (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335)	m³	27.64	100.00	2,764.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit C20/25 për kinetat e pusetave me përpunim sipas detalit, t=10 cm	m³	8.47	100.00	847.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave prej betonit të armuar (për puseta) Ø 1000/1000 mm (elemente të parafabrikuara)	m'	65.54	80.00	5,243.20 €
4	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i konuseve për puseta prej betonit Ø 600/1000/500 mm (elemente të parafabrikuara)	copë	55.00	55.00	3,025.00 €
5	Furnizimi dhe montimi i kapakëve për pesha të rënda deri në 42t (nga giza ose nga plastika-kompozit). Në çmim të llogaritet edhe rregullimi i kokës së pusetës me beton C-25/30 dhe një rrjetë armaturë Q-335	copë	55.00	150.00	8,250.00 €
6	Furnizimi, transporti, ndërtimi dhe montimi i pusetave ndihmëse atmosferike për lidhjen e kanalizimeve ekzistuese me kanalizimin e projektuar, duke i përfshirë të gjitha elementet përcjellëse të tyre si kapakët për pesha të rënda deri në 42t, kinetat, gypat dhe konuset.	copë	12.00	130.00	1,560.00

